



## **VENDIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMIT TË PANELIT**

**Data e miratimit: 6 korrik 2022**

**Nr. i lëndës: 2018-01**

**Y.B. 2**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 6 korrik 2022, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Snježana BOKULIĆ, ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit  
Z. Alexander FASSIHI, anëtar

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURA PRANË PANELIT**

1. Kjo ankesa është regjistruar më 20 shkurt 2018.
2. Me letrën e datës 6 nëntor 2018, Paneli ka informuar përfaqësuesin e ankuesit se shefi i Misionit ("ShM") i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Misioni") ishte informuar se ky rast ishte regjistruar.
3. Më 22 mars 2019, Paneli ka komunikuar ankesën ShM-së, duke e ftuar Misionin që të paraqesë vërejtje me shkrim mbi çështjet e ngritura në ankesë, jo më vonë se data 3 maj 2019.
4. Përmes postës elektronike të datës 19 prill 2019, Misioni ka kërkuar zgjatje të afatit për të paraqitur vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës. Përmes postës elektronike të datës 25 prill 2019, Paneli e zgjati afatin deri më 3 qershor 2019.

5. Përmes postës elektronike të datës 30 maj 2019, Misioni ka informuar Panelin se kërkonte informacion shtesë para se t'i përfundonte vërejtjet e tij.
6. Me letrën e datës 13 qershor 2019, ankuesit iu kërkua të siguronte informacion shtesë siç kërkohet nga ShM-ja. Ankuesi u ftua t'i ofronte këto dokumente deri më datën 14 korrik 2019.
7. Më 14 korrik 2019, ankuesi ka kërkuar një zgjatje të shkurtër të afatit. Paneli e zgjati afatin deri më 15 gusht 2019.
8. Më 30 korrik 2019, ankuesi ka dorëzuar dokumentet shtesë të kërkuara.
9. Me letrën e datës 5 gusht 2019, Paneli ka dorëzuar dokumentet shtesë tek ShM-ja dhe ka ftuar Misionin që të japë komentet e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e çështjeve të ngritura në ankesë deri më 16 shtator 2019.
10. Përmes postës elektronike të datës 3 mars 2020, Misioni ka treguar se kishte vendosur t'i jepte përparësi paraqitjes së vërejtjeve të tij mbi pranueshmërinë dhe/ose meritat në rastet e pazgjdhura që datojnë që nga viti 2016, para se të vazhdonte me rastet pasuese.
11. Përmes postës elektronike të datës 12 mars 2020, Misioni ka informuar Panelin se numri i ankesës 2018-01 ishte "në shqyrtim e sipër" nga Zyra e Misionit për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Ligjore.
12. Më 29 mars 2021, ShM-ja ka paraqitur vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës.
13. Më 31 mars 2021, vërejtjet e ShM-së iu dërguan ankuesit, të cilit iu dha afat deri më 31 maj 2021 për të bërë ndonjë parashtrim të mëtejshëm në përgjigje të asaj letre.
14. Më 31 maj 2021, përfaqësuesi i ankuesit ka konfirmuar përmes telefonit se ata nuk kishin ndërmend të jepnin ndonjë përgjigje tjetër.
15. Më 16 shtator 2021, Paneli nxori vendimin e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e rastit ([\(9.14.2022\)2021-09-16 Admissibility and Findings - 2018-01-a scanned.pdf \(hrrp.eu\)](#)). Në atë vendim, Paneli refuzoi kërkesën e ankuesit për masë të përkohshme dhe kërkesën e Misionit për të hequr ankesën nga lista e ankesave. Paneli konstatoi se ankesa në pajtim me nenin 6(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) ishte e papranueshme si haptazi e pabazuar, por konstatoi se ankesa në pajtim me nenin 8 të së njëjtës Konventë ishte e pranueshme. Paneli konstatoi se Misioni kishte shkelur të drejtat e ankuesit të mbrojtura sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, Paneli ftoi ShM-në të bëjë një deklaratë publike për të pranuar se rrethanat e rastit përbënin shkelje të të drejtave të ankuesit si rezultat i akteve që i atribuohen EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv dhe ftoi Misionin që t'i raportojë Paneli lidhur me atë rekomandim jo më vonë se data 15 dhjetor 2021.
16. Më 20 dhjetor 2021, ShM-ja dorëzoi komentin e Misionit ndaj rekomandimit të Panelit.
17. Më 22 dhjetor 2021, komenti i ShM-së iu transmetua ankuesit për informacion.

## II. PËRBËRJA E PANELIT

18. Pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të tij të jashtëm, Paneli do të mbledhet për këtë çështje me vetëm dy anëtarë në përputhje me rregullën 14 të rregullores së punës së Panelit.
19. Një nga anëtarët në largim u zëvendësua nga znj. Bokulić pas emërimit të saj në Panel. Për të siguruar që të njihet me rastin, znj. Bokulić u njoh me dosjen e rastit dhe si rezultat është plotësisht në gjendje të marrë pjesë në shqyrtimin e rastit.

## III. FAKTET

20. Ankuesi është banor i Bosnjës dhe Hercegovinës.
21. Më 4 korrik 2014, një prokuror i EULEX-it në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë kundër një N.K. në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Ai u akuzua për krim të organizuar, vrasje të rëndë dhe vepra të ndryshme penale në lidhje me drogë, të cilat dyshohet se kishin ndodhur në Bosnje dhe Hercegovinë.
22. Emri i ankuesit ishte shfaqur në aktakuzë. Në veçanti, aty thuhej se i akuzuari N.K. “*në bashkëkryerje*” me ankuesin dhe disa persona të tjerë,

*“organizoj, themeloj, mbikëqyri, menaxhoi dhe/ose drejtoi këtë Grup Kriminal të Strukturuar dhe të Organizuar (GKO) ose mori pjesë aktive në këtë GKO, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të kontribuojë në kryerjen e krimit të rëndë të vrasjes së rëndë ndaj shefit të bandës rivale. [RD] (...)”.*

23. Aktakuza më tutje parashtrroi se N.K. kishte,

*“ndjekur një numër takimesh me [ankuesin dhe persona të tjerë], në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pjesëmarrësit e këtyre takimeve formuan një grup kriminal të organizuar dhe të strukturuar për të planifikuar, komplotuar dhe vrarë shefin e bandës rivale [R.D]. (...)”.*

24. Më 1 shkurt 2018, Gjykata Themelore e Prishtinës nxori aktgjykimin (PKR 375/14) kundër N.K. dhe e shpalli fajtor për një pikë të aktakuzës, por e liroi atë nga pikat që lidhen me pjesëmarrjen në një Grup të Organizuar Kriminal së bashku me persona të tjerë, përfshirë ankuesin.
25. Më 2 shkurt 2018, prokurori i EULEX-it i caktuar për rastin mori pjesë në një program televiziv të quajtur “*Drejtësia në Kosovë*”. Në këtë program, prokurori i EULEX-it u intervistua, së bashku me disa persona të tjerë të përfshirë në gjykim.
26. Gjatë intervistës së tij, prokurori i EULEX-it gjithashtu iu referua disa herë ankuesit. Prokurori i EULEX-it përmendi se në Bosnje dhe Hercegovinë ishte duke u zhvilluar një proces gjyqësor kundër ankuesit për kërcënim dhe frikësim të një dëshmitari. Ai po ashtu ka thënë se prokuroria ka pretenduar se ankuesi ka urdhëruar që vrasja të kryhet nga një anëtar i grupit të organizuar kriminal. Më tej, prokurori i EULEX-it pretendoi se ankuesi përdori perandorinë e tij mediatike për të shkatërruar reputacionin e dëshmitarëve.
27. Më 8 shkurt 2018, ankuesi i shkroi kryeprokurorit të EULEX-it për t’u ankuar rreth deklaratave të dhëna nga prokurori i EULEX-it në intervistë. Ankuesi iu referua Vendimit dhe Gjetjeve të datës 19 tetor 2016 të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në

lëndën numër 2014-37 që kishte gjetur një shkelje të ngjashme të mëparshme të të drejtave të ankuesit sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kishte bërë rekomandime për shëfën e EULEX-it. (Shih: [Decision and findings 2014-37-a.pdf \(hrrp.eu\)](#))

28. Në ankesë, ankuesi gjithashtu ka kërkuar që të merren masa të caktuara nga kryeprokurori i EULEX-it.
29. Me letrën e datës 12 shkurt 2018, kryeprokurori i EULEX-it refuzoi ankesat. Megjithatë kryeprokurori i EULEX-it lëshoi një komunikatë për media më 14 shkurt 2018 duke dashur të sqarojë “se në asnjë moment gjatë procedurës penale në Gjykatën Themelore të Prishtinës [ankuesi] nuk ka qenë i pandehur dhe se nuk ka pasur ndonjë konstatim gjyqësor se [ankuesi] ishte i përfshirë në çfarëdo mënyre në vrasjen e supozuar”.
30. Ankuesi pretendon se veprimet e prokurorit të EULEX-it kanë shkelur të drejtat e tij në dhënien e deklaratave publike që krijuan përshtypjen se:
  - a. Ankuesi ishte paditur për vrasje në rastin kundër N.K.;
  - b. Është vërtetuar faktikisht se ankuesi ishte gjetur të jetë përgjegjës për akte të rënda të kanosjes së dëshmitarëve, përfshirë kërcënimet me vdekje.
31. Ankuesja pretendon se këto veprime:
  - a. Kanë shkelur prezumimin e tij të pafajësisë, siç mbrohet nga neni 6(2) i KEDNj-së; dhe
  - b. Kanë shkelur të drejtën e tij për jetë private duke dëmtuar reputacionin e tij sipas nenit 8 të KEDNj-së.
32. Ankuesi pretendon se serioziteti dhe dëmi i shkaktuar nga këto shkelje janë përkeqësuar më tej nga:
  - a. Fakti që prokurori i EULEX-it ishte udhëzuar më herët nga gjykatësi i Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut se deklaratatë të tilla do të minonin mbrojtjen dhe sigurinë e ankuesit dhe do të shkelnin të drejtat e tij sipas nenit 8 të KEDNj-së; dhe
  - b. Dështimi i Misionit për t'i respektuar plotësisht direktivat e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut për të ndërmarrë hapa të veçantë për të siguruar që prokurorët e EULEX-it nuk kanë kryer shkelje të mëtejshme të të drejtave të ankuesit dhe për të lëshuar një deklaratë që do të kishte ndihmuar në korrigjimin e reputacionit të ankuesit.
33. Paneli në vendimin e tij të datës 16 shtator 2021 ka konstatuar se kërkesa e ankuesit për propozimin e një mase të përkohshme ishte e pabazë dhe për këtë arsye Paneli e kishte refuzuar kërkesën (paragrafi 103). Paneli ka konstatuar se çështjet e ngritura në ankesë kanë merituar shqyrtim të mëtejshëm, pavarësisht ngjarjeve të mëpastajshme dhe për këtë arsye Paneli ka refuzuar kërkesën e ShM-së për të hequr ankesën nga lista e ankesave (paragrafi 104).
34. Për më tepër, në vendim Paneli ka konsideruar se ankuesi nuk e kishte vërtetuar pretendimin e tij se deklaratat e bëra nga prokurori i EULEX-it në programin televiziv “Drejtësia në Kosovë” kishin mjaftueshëm ndonjë lidhje të ngushtë me procedurat në Bosnjë dhe Hercegovinë që në atë mënyrë ato kishin shkelur të drejtën e ankuesit për prezumimin e pafajësisë në procedurën penale ndaj tij në Bosnjë dhe Hercegovinë. Për këtë arsye, Paneli ka konstatuar se ankesa për shkelje të së drejtës për prezumimin e

pafajësisë siç garantohet me nenin 6(2) të KEDNJ-së ishte e papranueshme, si qartazi e pabazuar (par.105).

35. Së fundi, Paneli ka konstatuar se deklaratat publike të bëra nga prokurori i EULEX-it në programin televiziv *“Drejtësia në Kosovë”* më 2 shkurt 2018 përbëjnë ndërhyrje ndaj të drejtës së ankuesit në respektimin e reputacionin e tij dhe se kjo ndërhyrje nuk ishte e justifikuar. Prandaj, Paneli ka konstatuar se kishte pasur shkelje të së drejtës së ankuesit në respektimin e jetës së tij private sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (par.106).

#### **IV. VLERËSIMI PASUES NGA PANELI SIPAS RREGULLËS 45 E TUTJE**

36. Në vendimin e tij më 16 shtator 20121, Paneli ka ftuar ShM-në të bëjë një deklaratë publike duke pranuar se rrethanat e rastit përbënin shkelje të të drejtave të ankuesit si rezultat i akteve që i atribuohen EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv. Paneli gjithashtu ka ftuar Misionin që t'i raportojë Panelit lidhur me rekomandimet e mësipërme sa më shpejt që të jetë e mundur, apo deri më datën 15 dhjetor 2021.
37. Më 20 dhjetor 2021, ShM-ja ka dorëzuar komentin e Misionit ndaj rekomandimeve të Panelit:

*“Përderisa i marr parasysh gjetjet e Panelit në këtë rast, konsideroj se vendimi flet vetë dhe prandaj një deklaratë që pranon shkeljen e të drejtave të ankuesit nuk është e nevojshme”.*

38. Paneli shpreh keqardhje që Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e Panelit.
39. Paneli thekson se përderisa rekomandimet e tij nuk janë ligjërish të detyrueshme, është thelbësore për kredibilitetin dhe legjitimitetin e Misionit (mision për sundimin e ligjit) që duhet të demonstrojë me vendosmëri dhe besueshmëri përkushtimin e tij ndaj respektimit efektiv të të drejtave të njeriut duke siguruar se veprimet e tij të jenë çdo herë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut – dhe se është përgjegjës aty ku nuk i ka përmbushur ato standarde. Paneli ka theksuar në disa vendime se pranimi i shkeljes së të drejtave të njeriut mund të jetë një masë e rëndësishme dhe kuptimplotë për ankuesin. Është gjithashtu një mënyrë për Misionin që “të përmirësojë” pjesërisht mosrespektimin dhe mbrojtjen nga ana e tij e të drejtave të njeriut të ankuesit. Për fat të keq, Misioni ka refuzuar ta bëjë këtë.
40. Paneli shpreh keqardhje që Misioni shfaq shpërfillje ndaj obligimeve të veta për të drejtat e njeriut duke mos e zbatuar rekomandimin. Paneli nuk e sheh të vlefshme të përsërisë rekomandimin duke pasur parasysh qartësinë e rekomandimit dhe qëndrimin e Misionit në lidhje me të. Përgjegjësia për t'i ofruar ankuesit ndonjë mjet juridik, përmes rekomandimit, për shkeljen që Misioni është konstatuar se ka bërë, mbetet edhe pasi Paneli, ashtu si tani, vendos të mbyllë shqyrtimin e rastit.

#### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**DEKLARON** se Misioni nuk e ka zbatuar rekomandimin e Panelit;

**SHPREH KEQARDHJE** për moszbatimin dhe mosgatishmërinë nga ana e Misionit e rekomandimit të Panelit

**VENDOS** të mbyllë shqyrtimin e lëndës.

Për Panelin,

Snježana BOKULIĆ  
Ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit

Alexander FASSIHI  
Anëtar

